



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.355/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrahman Jakupi kandidat për Kuvendin Komunal në Shtime nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të rezultatit përfundimtar të KQZ-së lidhur me parregullsitë në ditën e votimit në Zgjedhjet Lokale 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 27.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.355/2025 e datës 26.10.2025 e parashtruar nga Rrahman Jakupi kandidat për Kuvendin Komunal në Shtime nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të rezultatit përfundimtar të KQZ-së lidhur me parregullsitë në ditën e votimit në Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12.10.2025.

A r s y e t i m

Më datë 26.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.355/2025, të paraqitur nga Rrahman Jakupi kandidat për Kuvendin Komunal në Shtime nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, në të cilën pretendon se gjatë procesit zgjedhor për Kryetar të Komunës së Shtimes dhe Kuvendin Komunal (zgjedhjet e datës 12 tetor 2025), janë vërejtur parregullsi serioze që cenojnë integritetin e procesit dhe mund të kenë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatit përfundimtar, si vijon: Rasti "Treni Bullgar" në vendvotimin 2207/01 (fshati Belincë, Komuna e Shtimes) është gjetur një fletë-udhëzues për votim të përsëritur dhe mungon një fletëvotim origjinal për kryetarin e Komunës, çka tregon mundësinë e përdorimit të sistemit të organizuar të "Trenit Bullgar". Ky mekanizëm nënkupton që një votues hyn me një fletëvotim të plotësuar paraprakisht dhe del me fletën e paplotësuar për ta dorëzuar jashtë, duke e shfrytëzuar më pas në vendvotime të tjera. Tutje ka shtuar, ka pasur dhe raste të hapura nga Prokuroria Themelore lidhur me fotografimin e votës dhe kërcënimin e komisionerëve, në disa

vendvotime të tjera në Komunën e Shtimes (2201/06) është hapur rast në Prokurorinë Themelore në Ferizaj për fotografim i votës, presion ndaj votuesve dhe kërcënim ndaj komisionerëve të PDK-së, çka tregon veprime të koordinuara për deformim të vullnetit qytetar. Rezultati tepër i ngushtë për Kryetarin e Komunës (50,46%), i cili përjashton balotazhin me një diferencë minimale, ngrit dyshime serioze se parregullsitë e mësipërme mund të kenë ndikuar në rezultatin përfundimtar. Sipas Ligjit për Zgjedhjet Lokale, zgjedhjet duhet të zhvillohen në frymën e lirisë, barazisë dhe fshehtësisë së votës, pa ndikim apo presion politik. Parregullsitë e përmendura (treni bullgar, mungesë fletëvotimi origjinal, kërcënime dhe fotografime të votës) cenojnë drejtpërdrejt parimin e fshehtësisë dhe integritetit të votës. Duke qenë se sistemi i "Trenit Bullgar" nuk kufizohet vetëm në një vendvotim, por mund të shfrytëzojë të njëjtin fletëvotim të nxjerrë nga një qendër për përdorim në qendra të tjera, dyshimi i bazuar shtrihet në tërë territorin e Komunës së Shtimes. Kjo gjendje e bën të pamundur të garantohet vullneti i lirë dhe real i votuesve dhe për pasojë nuk mund të certifikohet rezultati i zgjedhjeve pa u përsëritur votimi. Si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e deklaratave të dy komisionerëve, kopje e shënimit të librit të votimeve 2207/01 (fshati Belinc, komuna e Shtimes) dhe artikuj të mediave.

Në përgjigjen në ankesë KQZ, me datë 27.10.2025, thekson se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Në lidhje me rastin e paraqitur në ankesë, lidhur me vendvotimin 2207/01 në fshatin Belincë, komuna e Shtimes, KQZ me vendimin e datës 22.10.2025, ka miratuar rekomandimin e QNR-së për rinumërimin e gjashtëmbëdhjetë (16) vendvotime, të cilat kanë pasur mospërputhje midis numrit të nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe numrit të fletëvotimeve brenda kutisë së votimit, për zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura me 12 tetor 2025. Ndër vendvotimet e rinumëruara, ka qenë edhe vendvotimi nr. 2207/01 ku është rinumëruar kutia për kryetar komune. Rezultatet e dala pas rinumërimit janë përfshirë në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për kryetar komune të publikuara nga KQZ me datën 25.10.2025.

Bazuar në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit përcaktohet në mënyrë të detajuar mbarëvajtja dhe ecuria, obligimet në vendvotim. Gjithashtu, në bazë të nenit 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit vlejné procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesë dhe të gjitha provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimin se në ditën e zgjedhjeve ka pasur mundësinë e përdorimit të sistemit të organizuar të "Trenit Bullgar" me fletëvotime, pasi është gjetur një fletë-udhëzues për votim të përsëritur dhe mungon një fletëvotim origjinal për kryetarin e Komunës, Paneli vlerëson se në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Në rastin konkret, Paneli duke u mbështetur edhe në përgjigjen e KQZ-së, nuk mundi të vërtetojë faktin nëse një keqpërdorim i tillë ka ndodhur, por vetëm është evidentuar një parregullsi lidhur me një fletë-udhëzues, i cili fare nuk ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, për shkak se ky fletëvotim edhe pse nuk ekziston, nuk ka pasur ndikim në rezultat për shkak se e njëjta nuk është numëruar për asnjërin kandidat. Për më tepër, lidhur me pretendimin se këto parregullësi kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar, nuk qëndrojnë për arsye se sipas vlerësimit të Panelit edhe KQZ-ja ka konstatuar se e ka dërguar në rinumërim vendvotimin 2207/01, dhe në rezultatin përfundimtar të kryetarëve të komunave është përfshirë numri i votave pas rinumërimit. Prandaj ankuesi nuk e ka dëshmuar me asnjë dëshmi bindëse faktin se ka pasur një sistem të votimit i ashtuquajtur "Treni Bullgar" në vendvotim, siç pretendohet në ankesë.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Rrahman Jakupi kandidat për Kuvendin Komunal në Shtime nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur shkelja e pretenduar në procesin e votimit me datën 12.10.2019, në vendvotimit 2207/01.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.355/2025 më datën 27.10.2025

Kryesuese e panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.